



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM EKONOMIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, _____.____.2025

Lënda: Kthim përgjigje

I nderuar

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion lidhur me procesin e rikonstruksionit të godinës së Markatës, ju bëjmë me dije se, siç jeni në dijeni, godina e Markatës është objekt i një rikonstruksioni të plotë, me qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukturore, funksionale dhe higjieno-sanitare, si dhe riorganizimin e ambienteve të tregtimit sipas standardeve bashkëkohore.

Aktualisht, projekti ndodhet në fazën e zbatimit të investimit. Për çështjet që ngrini në kërkesën tuaj, ju informojmë se detajet përfundimtare lidhur me sistemin e përkohshëm të tregtarëve, kriteret e shpërndarjes së ambienteve pas përfundimit të punimeve, tarifat përkatëse, si dhe çdo masë mbështetëse apo lehtësuese, do të bëhen publike dhe do t'u komunikohen subjekteve të interesuara në momentin e miratimit të procedurave dhe akteve përkatëse administrative.

Bashkia është e angazhuar që procesi i rikonstruksionit dhe riorganizimit të zhvillohet në mënyrë transparente, duke marrë në konsideratë interesat e tregtarëve që aktualisht ushtrojnë aktivitet në këtë treg dhe që kanë përbushur detyrimet e tyre ligjore.

Sa i përket të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga kontratat ose marrëveshjet ekzistuese, ato do të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimmarrjet që do të shoqërojnë procesin e riorganizimit të tregut.

Afatet e realizimit të punimeve do të jenë ato të përcaktuara në kontratën e zbatimit të projektit dhe do t'u bëhen të njohura të gjitha palëve të interesuara nëpërmjet njoftimeve zyrtare.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, ju sigurojmë se çdo informacion i mëtejshëm do t'ju vihet në dispozicion në kohën e duhur dhe në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Benet Beci

Me Vendim Delegimi
ZV/Kryetar

Alban Preka